

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.41/2018	Data: 30.04.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 58 pika h). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 19 të Ligjit Nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ(MTI) Nr. 15/2016 për mënyrën e themelimit, funksionimit dhe administrimit të inkubatorëve të biznesit, në mbledhjen e mbajtur me 30.04.2018, shqyrtoi: Propozim-Vendimin për themelimin e inkubatorit të biznesit dhe mori:

VENDIM PËR THEMELIMIN E INKUBATORIT TË BIZNESIT

1. Themelimi i inkubatorit të biznesit bëhet në objektin e shtëpisë së kulturës "Adem Jashari" me sipërfaqe prej 50m², objekti është me numër të njësisë kadastrale P-70806020-00736-3 dhe P-70806020-736-2, i cili ofron ambient fizik dhe ambient biznesi për ndërmarrësit e rinjë dhe atyre të cilët në mungesë të hapësirave nuk mund të zgjerojnë kapacitetet e tyre afariste, ofron shërbime të përbashkëta në ndërmarrësi, qasje në pajisje teknike si dhe avancim profesional.
2. Inkubatori i biznesit administrohet nga themeluesi i cili ka për detyrë të siguroj kushte të përshtatshme organizative, hapësirë, infrastrukturë dhe shërbimeve tjera publike që nevojiten për kryerjen e veprimtarisë afariste.
3. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e komunës. Obligohet Kryetari i Komunës - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe një kopje në arkivin e Kuvendi të Komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E ISTOGÛT - OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRBGJITHSHVE
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës - Izdajna

Nr. 01-039-4

Data 07.05.2018

Br.

Datum

ISTOG-ISTOK



KRYESUESI I KUVENDIT

z. Qaush Balaj

